



**OCTOPUS Journal: Hybrid Warfare & Strategic Conflicts**

[www.octopusinstitute.org](http://www.octopusinstitute.org)

<https://octopusinstitute.org/ojs/index.php/octopus-journal>

Double-Blind Peer-Reviewed

ISSN Online: 3006-5925

ISSN Print: 3006-5917

Volume 2, 2024

## **PUSH AND PULL: SI SERBIA PËRDOR TAKTIKA KËRCËNUESE DHE NEGOCIUESE PËR TË NDIKUAR NË STABILITETIN E KOSOVËS**

Agim Musliu

Drejtor në Institutin për Studime të Luftës Hibrade “OCTOPUS”

[agim.musliu@octopusinstitute.org](mailto:agim.musliu@octopusinstitute.org)

Serbia ka ndërmarrë një qasje të dyfishtë në marrëdhëniet e saj me Kosovën, një çështje kyçe për stabilitetin rajonal. Nën udhëheqjen e Presidentit Aleksandër Vuçiq, Serbia ka përdorur një kombinim të kërcënimeve dhe negociatave për të avancuar interesat e saj kombëtare. Kjo strategji “shtytje dhe tërheqje (push & pull)” i lejon Beogradit të luhatet mes agresionit dhe diplomacisë, duke përdorur taktikën e kërcënimit për të destabilizuar Kosovën dhe për të konsoliduar mbështetjen e brendshme, ndërkohë që angazhohet në dialog kamoflazhi për të ruajtur legjitimitetin ndërkombëtar.

### **Nga Nacionalizmi në Dialog: Manovrat e Vuçiq-it në Kosovë**

#### **Strategjia e Shtytjes (push): Nacionalizmi Assertiv**

Vuçiq shpesh adoptan një qëndrim konfrontues ndaj Kosovës, duke iu referuar pretendimeve historike, kulturore dhe fetare të Serbisë mbi territorin e Kosovës. Kjo qasje nuk është vetëm retorikë; ajo mbështetet nga qëndrimi ushtarak dhe retorika agresive që shërbejnë për të mobilizuar sentimentin nationalist brenda Serbisë. Mbështetja e qeverisë së Serbisë për komunitetin serb në Kosovë, veçanërisht për figurat kontroverze, që nuk është mbështetje për zhvillim por mbështetje për destabilizim, i përkeqëson më tej tensionet etnike dhe e komplikon marrëdhënien tashmë të ndërlikuar ndërmjet dy shteteve.

Kjo strategji e shtytjes shërben për disa qëllime:

- *Mobilizimi i Mbështetjes Së Brendshme*: Duke theksuar pretendimet historike të Serbisë, Vuçiq apelon tek sentimentet nacional-shoviniste, duke konsoliduar bazën e tij politike.
- *Përmbajtja e Veprimeve të Kosovës*: Gatishmëria ushtarake dhe retorika agresive sinjalizojnë Kosovën dhe komunitetin ndërkombëtar se Serbia është e gatshme të mbrojë interesat e saj, duke ndërhyrë në punët e brendshme dhe vendosjen e rendit dhe ligjit në Kosovë.

### **Strategjia e Tërheqjes (pull): Angazhimi Pragmatik**

Më gjithë qëndrimin agresiv, Vuçiq me kamoflazzh angazhohet në dialog me Kosovën, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Kjo strategji e tërheqjes karakterizohet nga një gatishmëri për të negociuar dhe kërkuar normalizimin e marrëdhënieve, ndonëse nga një pozitë e forcës. Vuçiq pozicionohet si një lider pragmatik që është i hapur për diskutime, por gjithashtu kritik ndaj kushteve që po propozojnë, duke kërkuar të nxjerrë koncesione të rëndësishme që përputhen me interesat kombëtare të Serbisë.

Kjo qasje duale i lejon Vuçiq-it të:

- *Ruajtja e Legjitimitetit Ndërkombëtar*: Duke marrë pjesë në negociatë, Serbia mund të paraqitet si një aktor i përgjegjshëm në arenën ndërkombëtare, duke kundërshtuar akuzat si agresor.
- *Përdorë Mbështetjen e BE-së*: Angazhimi në dialog me Kosovën është thelbësor për ambiciet e integritetit të Serbisë në BE, duke i lejuar Vuçiq-it të sigurojë mbështetje dhe financim të nevojshëm nga blloku.
- *Realizon planet e “Botës Serbe”*: Qasja duale i mundëson që të përfitojë një politikë të paqëtimit nga perëndimorët por në anën tjetër nëpërmjet kësaj politike të sigurojë avancimin gradual të realizimit të Botës Serbe apo përgatitjes së terrenit për realizimin e saj në formë konvencionale në ndryshim të rrethanave gjeopolitike.

### **Bashkimi Evropian: Balancimi mes Kritikës dhe Integritetit**

#### **Shtytja (push): Kritika dhe Viktimizimi**

Vuçiq shpesh kritikon BE-në, duke e portretizuar Serbinë si viktimë e paragjyqimeve në dialogun me Kosovën. Kjo strategji mobilizon mbështetje të brendshme dhe rrit presionin për kushte më të mira për anëtarësimin e Serbisë. Duke paraqitur BE-në si një ndërmjetës të padrejtë, ai synon të vendosë Serbinë si një partner të keqkuptuar, që meriton më shumë konsideratë.

#### **Tërheqja (pull): Përkushtimi ndaj BE-së**

Në të njëjtën kohë, Vuçiq vazhdon t'i japë përparësi anëtarësimit në BE, duke e paraqitur si objektiv strategjik. Reforma të rëndësishme janë ndërmarrë për përputhje me standardet e BE-së, me qëllim sigurimin e mbështetjes dhe fondeve për zhvillim dhe stabilitet politik.

### **Motivet Pas Strategjisë**

1. **Leva në Negociata:** Kjo strategji i jep Vuçiq-it hapësirë për të nxjerrë koncesione dhe për të vonuar marrëveshje të pafavorshme.
2. **Kapitali Politik:** Portretizimi si mbrojtës i interesave kombëtare forcon mbështetjen e nacionalistëve.
3. **Fleksibilitet Gjeopolitik:** Vuçiq mban marrëdhënie me aktorë të shumtë, duke shmangur varësinë nga një fuqi e vetme.

### **Sfidat e Strategjisë**

**Negociatat e Vështira:** Strategjia e Vuçiq-it e ndërlikon dialogun me Kosovën, duke penguar ndërtimin e besimit dhe marrëveshjeve afatgjata.

**Pengesa në Integrimin në BE:** Lidhjet e forta të Serbisë me Rusinë dhe Kinën mund të ngadalësojnë procesin e integritimit në BE, pasi shpesh bien në kundërshtim me vlerat e BE-së.

**Rreziku për Stabilitetin Rajonal:** Ndërsa Vuçiq mund të pozicionohet si stabilizues, qëndrimi i tij i paqëndrueshëm dhe shpesh i paparashikueshëm rrezikon të përkeqësojë tensionet në rajon, duke ngjallur kundërshtime nga fqinjët dhe aktorët ndërkombëtarë.

### **Pozicionimet Ushtarake dhe Kërcënimet e Serbisë ndaj Kosovës**

#### **2018:**

*Mars - Arrestimi i Marko Gjuriqit në Mitrovicë:* Arrestimi i Marko Gjuriqit për hyrje ilegale në Mitrovicë shkaktoi një rritje të menjëhershme të tensioneve në rajon. Presidenti i Serbisë Vuçiq e urdhëroi ushtrinë serbe të ishte në gatishmëri të lartë dhe përdori retorikë kërcënuese për të ushtruar presion mbi Kosovën. Ky veprim kishte për qëllim të frikësonte Prishtinën dhe të ndikonte në dinamikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

**2019 dhe 2020:**

Gjatë këtyre dy viteve, Serbia nuk shfaqti ndonjë aktivitet të dukshëm ushtarak në afërsi të kufirit me Kosovën. Megjithatë, tensionet u mbajtën të larta përmes retorikës së ashpër dhe kërcënimeve diplomatike, ku Serbia vazhdoi të përdorte një retorikë përjashtuese dhe sfiduese ndaj Kosovës dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë.

**2021:**

Shtator - Implementimi i reciprocitetit për targa: Pas hyrjes në fuqi të masave të reciprocitetit për targa, Vuçiqi urdhëroi gatishmërinë e ushtrisë serbe dhe dislokoj automjete të blinduara dhe aeroplanë luftarakë pranë kufirit me Kosovën. Ky veprim ishte një kërcënim i hapur dhe kishte për qëllim të tregonte forcën politike dhe ushtarake të Serbisë. Ky hap shkaktoi një rritje të ndjeshme të tensioneve dhe ngriti shqetësime për stabilitetin në rajon nga ana e partnerëve ndërkombëtarë.

**2022:**

Korrik - Implementimi i rregullores së re kufitare: Rregullorja e re e Qeverisë së Kosovës që kërkonte dokumente dhe targa të veturave në formë legale edhe në veri të Kosovës shkaktoi tensione të mëdha. Vuçiqi e urdhëroi përsëri ushtrinë serbe të jetë në gatishmëri të lartë, ndërsa Serbia dislokoj trupat ushtarake pranë kufirit. Konflikti i mundshëm u shmang për shkak të përpjekjeve ndërkombëtare për të menaxhuar situatën, veçanërisht nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara.

Dhjetor - Përsëritja e tensioneve me barrikatad në veri të Kosovës: Pas arrestimit të një ish-oficeri të policisë serbe të Kosovës, serbët lokalë rivendosën barrikatad në veri të Kosovës. Vuçiqi e ngriti nivelin e gatishmërisë luftarake të ushtrisë serbe dhe dërgoi trupa shtesë dhe automjete të blinduara në zonën kufitare. Ky veprim ishte një nga veprimet më serioze të kërcënimit ushtarak që ka ndërmarrë Serbia në këtë periudhë.

**2023:**

Maj - Përplasjet gjatë zgjedhjeve lokale: Pas tensioneve të rritura gjatë zgjedhjeve lokale, përplasjet mes bandave serbe dhe forcave të sigurisë të Kosovës u intensifikuan. Vuçiqi e urdhëroi përsëri gatishmërinë e lartë ushtarake dhe dislokoj trupat dhe automjetet e blinduara më afër kufirit. Në këtë periudhë, KFOR-i u angazhua për të deeskaluar situatën dhe për të mbajtur stabilitetin në rajon.

Qershor - Protestat e dhunshme ndaj Policisë së Kosovës dhe KFOR-it: Protestat e dhunshme ndaj forcave të sigurisë dhe KFOR-it në veri të Kosovës e sollën sërish një rritje të gatishmërisë ushtarake nga ana e Vuçiqit. Përdorimi i kërcënimeve të hapura dhe mobilizimi ushtarak kishte për qëllim të tregonte gatishmërinë e Serbisë për të ndërhyrë në rast të ndonjë përshkallëzimi të mëtejshëm të situatës.

## 24 shtator 2023

Një grup i organizuar terrorist, i mirëpërgatitur dhe armatosur, i udhëhequr nga Milan Radojiçiq, kreu një sulm në fshatin Banjska, në komunën e Zveçanit, me qëllimin e qartë për të nxitur një përshkallëzim të situatës drejt konflikteve të armatosura. Ky akt terrorist, që përfshinte individë të trajnuar profesionalisht dhe të infiltruar nga Serbia, kishte për qëllim krijimin e një atmosfere destabilizuese në Kosovë. Grupit i ishin dhënë udhëzime të qarta nga autoritetet serbe për të provokuar tensione, duke synuar secesionin e veriut të Kosovës dhe minimin e stabilitetit të përgjithshëm të rajonit.

Strategjia e “shtytjes dhe tërheqjes” e Serbisë nën Vuçiq-in reflekton dinamika të ndërlikuara të gjeopolitikës bashkëkohore në Ballkanin Perëndimor. Ndërkohë që lejon një shkallë të fleksibilitetit në navigimin e marrëdhënieve me Kosovën, BE-në dhe fuqitë e tjera globale, ajo gjithashtu paraqet sfida të rëndësishme në lidhje me besimin, stabilitetin rajonal dhe ligjin ndërkombëtar. Ndërsa Serbia vazhdon të balancojë këto interesa të kundërta, dhe perëndimi vazhdon të luajë lojën e paqëtimit (appeasment) me Serbinë, gjendja në Ballkanin Perëndimor do të mbetet gjithmonë një pikë nevralgjike dhe e lehtë për ndikim nga forcat ruse nëpërmjet luftës hibride.

(CC BY-NC 4.0) This article is licensed to you under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc/4.0/). When you copy and redistribute this paper in full or in part, you need to provide proper attribution to it to ensure that others can later locate this work (and to ensure that others do not accuse you of plagiarism).